




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u bazuar në nenin 108, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.20 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës me qëllim të unifikimit të taksave gjyqësore, në mbledhjen 227-të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/2019 PËR PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.01/2017 PËR UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi është plotësimi i Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Neni 2

Në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ bazik, pas nën-paragrafit 8.1.5 i shtohen nën-paragrafët e ri si në vijim:

- 8.1.6 Viktimat e dhunës seksuale të luftës, si dhe
- 8.1.7 Personat me aftësi të kufizuara,

Neni 3

Në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ bazik, pas nën-paragrafit 8.3.5 i shtohen nën-paragrafët e ri si në vijim:

- 8.3.6 dëshmi mbi statusin e viktimës seksuale të luftës, dhe
- 8.3.7 dëshmi mbi statusin e personit me aftësi të kufizuara

Neni 4 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit dhe të nënshkrimit nga ana e kryesuesit të KGJK-së.

Prishtinë, më datë 16. 12. 2019



Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës